

## 12 TAKSA PËR ZËNIEN E HAPËSIRAVE PUBLIKE

Baza e taksës për zënie të hapësirave publike është sipërfaqja në m<sup>2</sup> e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi.

Taksa llogaritet si detyrim mujor i taksapaguesit

Kategoritë dhe nënkategoritë e taksës për zënie të hapësirave publike sipas zonave të banimit jepen si në tabelën e mëposhtme:

KATEGORIA DHE NËNKATEGORITË	NIVELI TREGUES I TAKSËS/MUAJ		
	ZONA A	ZONA B	ZONA C
<b>Zënie e hapësirës publike (përdorim trualli)</b>			
<b>Nënkategoritë</b>			
Organizimin e spektakleve ose panairove të ndryshme	150 lekë/m <sup>2</sup>	150 lekë/m <sup>2</sup>	150 lekë/m <sup>2</sup>
Zënia e Hapësirës publike për qëllime biznesi/tregtimi në Tregjet Publike të administruara nga Njësitë Bashkiake.	150 lekë/m <sup>2</sup>	150 lekë/m <sup>2</sup>	150 lekë/m <sup>2</sup>
Zënia e hapësirës publike për qëllime biznesi si vendosje mallrash jashtë vendit të tregtimit, vendosje tavolinash sipërfaqet e zëna me platforma, sipërfaqe të rrethuara me vazo me lule, bime dekorative, me kangjella, drurë dekorativ, kufizime me plasmasë dhe sende të tjera, etj të ngjashme me to.	150 lekë/m <sup>2</sup>	130 lekë/m <sup>2</sup>	120 lekë/m <sup>2</sup>

Detyrimi i taksës për llogaritet si shumëzim i bazës (sipërfaqes) me nivelet treguese të saj.

Pagesa e Taksës për zënie të hapësirës publike:

- Për rastin e përdorimit të truallit me qëllim organizimin e spektakleve ose panairove të ndryshme pagesa do të bëhet me marrjen e Lejes për Ushtrimin e Aktivitetit e cila do të jepet nga Drejtoria e Dhënies së Lejeve për Ushtrim Aktiviteti. Është kjo drejtori e cila kryen dhe llogaritjen e detyrimit për lejen përkatëse.
- Për rastin e përdorimit të truallit me qëllim ushtrimin e aktivitetit tregtar në Tregjet Publike që administrohen nga Njësitë Bashkiake detyrimi është mujor dhe pagesa do të bëhet brenda datës 30 të muajit përkatës pranë Njësisë Bashkiake
- Për rastin e përdorimit të truallit qëllim ushtrim aktiviteti tregtar si vendosje mallrash jashtë vendit të tregtimit, sipërfaqet e zëna me platforma , sipërfaqe të rrethuara me vazo me lule, bime dekorative, me kangjella, drurë dekorativ, kufizime me plasmasë dhe sende të tjera, etj të ngjashme me to, detyrimi është mujor dhe pagesa do të bëhet brenda datës 30 të muajit përkatës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore

**Taksapaguesit përfitojnë kushte lehtësuese kur:**

- lidhin kontratë për zënie të hapësirës publike me afat 6-mujor dhe paguajnë të plotë detyrimin në momentin e lidhjes së saj, përfitojnë reduktimin në masën 5% të vlerës së detyrimit.
- lidhin kontratë për zënie të hapësirës publike me afat 12-mujor dhe paguajnë të plotë detyrimin në momentin e lidhjes së saj, përfitojnë reduktimin në masën 10% të vlerës së detyrimit.

**Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Taksës për zënie të hapësirës publike janë:**

- Për nënkategorinë**
- Drejtorja e Dhënies së Lejeve për Ushtrim Aktiviteti
  - Njësitë Bashkiake
  - Drejtorja e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore